



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7790/21 datë:02.04.2021



Npi – 01/101 datë: 20.04.2021

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (c) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr 28/2008); Nenin 24 dhe 25 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.06-L-092; Nenin 29 paragrafi 5 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi – 01/272 Datë: 24.11.2020; Si dhe mbi bazën e Propozim-Vendimit të Kryetarit, Nr.02-08 të datës 14.01.2021, për këmbimin e pronës së paluajtshme, në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Npi-01-272, datë 24.11.2021, me të cilin i ka propozuar Kuvendit, të aprovoi Vendimin për Këmbimin e Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me Ngastrën Kadastrale Nr.333/3 dhe pjesën e mbetur nga Ngastra Kadastrale 333/4, Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar pronë e Komunës së Shtimes, sipas vlerësimit të Zyrës për vlerësimin e paluajtshmërive – Departamenti i Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave. Kuvendi i Komunës, duke marrë parasysh edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KËMBIMIN E PRONËS KOMUNALE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 20.04.2021, me shumicën e votave aprovoi vendimin për Këmbimin e Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, në Zonën Kadastrale – Davidovc, Kultura: Kullosë e klasës së -I- (parë). Evidentuar pronë e Sali /Fehmi/ Beqaj nga fshati Petrovë, me gjithsej sipërfaqe: 10.248m², (Dhjetë mijë e dyqind e katërdhjetë e tetë) metra katrorë, me sipërfaqe të barazvlefshme me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes, komplet parcela me numër P-333/3 dhe pjesa e mbetur të merret nga P-333/4 Zona Kadastrale – Davidovc, Kultura: Kullosë e klasit të -I- (parë), Evidentuar pronë e Komunës së Shtimes (këmbimi të fillojë në kufinj të parcelës fqinje STN “ Betoni “ dhe i adresohet MEF-it, Departamentit për vlerësim, për procedim tutje).

II

A r s y e t i m: Këmbimi i pronës së paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes me pronën e personit fizik, Sali /Fehmi/ Beqaj nga fshati Petrovë, sipas dispozitivit të këtij vendimi është bërë në ekuivalencë të plotë, mbi bazën e Nenit 24 dhe 25 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.06-L-092, vetëm për qëllimin e përmbushjes së interesit publik, për rregullimin e varrezave të fshatit, Parkut rekreativ sportiv, si dhe objekte të tjera me interes publik, të cilat i parsheh, Plani Zhvillimor i Komunës së Shtimes 2009-2020.

III

Obligohet, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, që në bazë të këtij vendimi të bëjë ndarjen, dhe përkufizimin e sipërfaqeve në teren, si dhe të kryej evidentimin e ndryshimeve në librat kadastral.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj